

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6505
E shtunë, 8 janar 2022
çmimi 0.40

**Bislimi: Qeveria
e gatshme ta vazhdojë
procesin e dialogut** | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

**NË MOSHËN 93-VJEÇARE KA NDËRRUAR JETË AJSHE VESELI,
NËNA E KADRI VESELIT** | FAQE 4-5

I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT NËNËS SË KADRI VESELIT



Ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe të PDK-së, Kadri Veseli, i cili gjendet në paraburgim në Hagë, të premtën i ka vdekur nëna. Ajshe Veseli ka vdekur në moshën 93-vjeçare. Ajo është varrosur në Broboniq të Mitrovicës. Për këtë humbje të madhe familjen Veseli e kanë ngushëlluar krerët e institucioneve, bashkëpartiakët dhe ish-bashkëluftëtarët e Kadri Veselit. Në telegramet e ngushëllimit të tyre nëna Ajshe është vlerësuar si grua e fortë dhe bujare, e cila rriti dhe edukoi bijtë e saj në frymën e atdhedashurisë. Gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim, Veselit i ka vdekur edhe babai, Fazli Veseli

Kosova regjistron edhe 144 të infektuar me Covid

FAQE 6



NË SKENDERAJ PROTESTOHET KUNDËR VRASJES SË GRUAS NGA LLAUSHA

FAQE 3

AKTUALE



FRANCA DHE KE-ja BASHKËPUNOJNË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

 | F. 2

SBASHK-U: NËSE NUK RESPEKTOHEN AFATET PËR LIGJIN E PAGAVE, MUND TË KETË GREVË

 | F. 6

550 MIJË SHQIPTARË JANË LARGUAR NGA VITI 1969

 | F. 6

EKONOMI



PRODHUESIT E KRIPTOVALUTAVE: QEVERIA PO NA DETYRON T'I SHESIM

 | F. 8

BUZHALA: GJENDJA ME ENERGJI ËSHTË STABILE

 | F. 8

SPORT



VUSHTRRIA, MISION SUPERLIGËN, RIKTHEN ZABERGJËN DHE EMININ

 | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania ashpërsion masat kundër pandemisë

BERLIN, 7 JANAR - Liderët gjermanë janë pajtuar të premtën që t'i ashpërsojnë kriteret për hyrjen në restorante dhe bare si dhe ta shkurtojnë periudhën e karantinës dhe të vetizolimit për personat e vaksinuar teksa varianti "Omicron" i koronavirusit po përhapet me shpejtësi në mbarë vendin. Kancelari gjerman Olaf Scholz dhe 16 udhëheqësit e shteteve gjermane kanë vendosur që t'i forcojnë kufizimet e paraqitura pas Krishtlindjes, duke kufizuar tubimin e njerëzve deri në dhjetë veta dhe duke mbyllur klubet e natës.

Qytetarët gjermanë më herët ishte dashur që të dëshmojnë se janë të vaksinuar plotësisht në mënyrë që të mund të hynin në restorante dhe bare,

por edhe në dyqane të tjera jothelbësore, teatro dhe kinema.

Vendimi i së premtës bën thirrje për rivendosjen e kësaj mase për restorantet dhe baret. Të gjithë personat që duan të hyjnë në këto lokale të gastronomisë tani duhet të dëshmojnë se e kanë marrë dozën përforcuese të vaksinës kundër koronavirusit ose të paraqesin një test negativ apo dëshmi se janë shëruar nga sëmundja Covid-19. "Gjysma e popullatës do ta marrë dozën përforcuese brenda disa ditësh dhe ata do të mund të shkojnë në restorante pa treguar test negativ", u ka thënë gazetarëve kryetarja e Berlinit, Franziska Giffey.

Megjithatë, shteti lindor i Saxony-Anhalt nuk është pajtuar që të vendosë këtë



masë sepse në këtë shtet shumica e rasteve janë me variantin "Delta", ndërkaq përfaqësuesit e Bavarisë thanë se janë skeptikë për këtë masë. Scholz dhe liderët e tjerë janë pajtuar që ta shkurtojnë kohën e karantinës dhe të vetizolimit

që aktualisht është deri në 14 ditë.

Njerëzit e imunizuar me dozën përforcuese nuk do të detyrohen që të izoloohen pas kontaktit me ndonjë të infektuar. Kjo masë do të vlejë edhe për personat e vaksinuar

me të dyja dozat apo që janë shëruar nga koronavirusi në tre muajt e fundit.

Ndërkaq, personat e tjerë do të duhet të futen në karantinë apo të vetizoloohen për dhjetë ditë dhe nëse nuk kanë simptoma, mund ta shkurtojnë periudhën e izolimit në shtatë ditë, pasi të kenë dalë negativë në testin për koronavirus.

"Këto janë rregulla strike, por janë pragmatike dhe kanë për qëllim që t'i lehtësojnë masat aktuale", ka thënë Scholz.

Të premtën Gjermania raportoi për 56 335 raste të reja me koronavirus. Ndërkaq, autoritetet shëndetësore thanë se 44.3 për qind e rasteve në Gjermani javën e kaluar ishin me "Omicron", shifër më e lartë krahasuar me një javë më parë kur 15.8 për qind e rasteve ishin me këtë variant.

Ministrat e NATO-s, qëndrim të përbashkët lidhur me agresionin rus

BRUKSEL, 7 JANAR - Të 30 anëtarët e NATO-s janë bashkuar kundër veprimit ushtarak rus në Ukrainë, ka thënë më 7 janar misioni i Shteteve të Bashkuara në këtë aleancë, pas një takimi virtual të ministrave të Jashtëm të NATO-s.

"Ministrat e Jashtëm të të gjitha shteteve të NATO-s ritheksuan unitetin tonë në përgjigje të agresionit rus kundër Ukrainës gjatë takimit të sotëm të jashtëzakonshëm. Përpara takimit të Këshillit NATO - Rusi ministrat theksuan nevojën për



diplomaci, dialog dhe shtensionim të situatës", është thënë në deklaratën e misionit. Ministri i Jashtëm i Letonisë, Edgars Rinkevics, ka komentuar në "Twitter" pas përfundimit të takimit. "Takim i mirë i ministrave të jashtëm të NATO-s.

Uniteti i aleatëve, mbrojtja efikase, kolektive dhe mbështetja për partnerët tanë janë elementet kryesore për ta trajtuar sjelljen agresive të Rusisë", shkroi ai në "Twitter". "Ne jemi të gatshëm që të angazhohemi në dialog me Rusinë, por jo në kurriz të vlerave apo parimeve tona kryesore", ka thënë ai.

Ministrat e jashtëm kanë mbajtur takimin virtual në mes të paralajmërimeve të Perëndimit pas grumbullimit të dhjetëra mijërave trupave ruse

në kufi me Ukrainën, teksa presidenti rus, Vladimir Putin, po kërkon garanci që Ukraina të mos anëtarësohet në NATO.

Zyrtarët perëndimorë kanë thënë se rreth 90 000 trupa ruse dhe pajisje janë vendosur pranë kufirit ukrainas. Moska vazhdimisht e ka akuzuar ShBA-në për destabilizim në Detin e Zi dhe në rajonin përreth, duke thënë se vendosja e trupave ruse është çështje e brendshme e Rusisë.

Lidhur me shqetësimet për një pushtim të mundshëm të

Ukrainës nga Rusia, por edhe për garancitë e sigurisë që po kërkon Moska, diplomatët amerikanë dhe rusë do të takohen në Gjenevë më 10 janar në përpjekje për t'i ulur tensionet.

Po të njëjtën ditë ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, do ta vizitojë selinë e NATO-s në Bruksel. Këshilli NATO - Rusi do të takohet më 12 janar për të diskutuar për Ukrainën dhe për uljen e rrezikut. Ky do të jetë takimi i parë i këtij këshilli që prej vitit 2019.

Franca dhe KE-ja bashkëpunojnë për Ballkanin Perëndimor

Paris, 7 janar - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se shteti i tij gjatë kryesimit të Presidencës së bllokut evropian do të punojë së bashku me Komisionin Evropian edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këto komente Macron i ka bërë në një konferencë të përbashkët për medie me presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Franca ka marrë kryesimin gjashtëmujor të Presidencës së Bashkimit Evropian nga 1 janari. Presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, ka thënë se e mirëpret

faktin që Franca, si një shtet me peshë të madhe politike dhe me përvojë, ka marrë kryesimin e presidencës dhe se institucioni që ajo udhëheq do të jetë në dispozicion për të bashkëpunuar për realizimin e prioritetëve të përbashkëta të BE-së.

Macron dhe von der Leyen kanë folur për gazetarët pas takimit të parë të punës që pati kolegji i komisionarëve të BE-së me qeverinë franceze, si kryesuese e radhës së BE-së.

Burimet nga presidenca franceze kanë thënë se do të angazhohen gjatë këtyre gjashtë muajve edhe

për ta avancuar procesin e zgjerimit me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke pasur parasysh edhe përmbushjen e kushteve në këtë proces, sipas metodologjisë së re të zgjerimit. Sipas burimeve diplomatike, Franca pritet sidomos të punojë për tejkalimin e pengesave për nisjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Pas krijimit të Qeverisë së re në Bullgari pritet që të gjendet edhe një zgjidhje për t'i hequr pengesat që ky shtet i ka bërë për nisjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë



e Veriut, raporton "Rel".

Franca gjatë kryesimit të saj me BE-në do të organizojë edhe një konferencë të veçantë kushtuar Ballkanit Perëndimor, në të cilën

do të diskutohet për problemet specifike, sidomos për tensionet politike në Bosnjë e Hercegovinë dhe për raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Një muaj paraburgim për të arrestuarit në rastin “Brezovica”

FERIZAJ, 7 JANAR - Gjykata Themelore e Ferizajt ka miratuar kërkesën e Prokurorisë për masën e paraburgimit për një muaj ndaj tre të arrestuarve në rastin e njohur si “Brezovica”. Të pandehurit me iniciale B. H., A. Ç. dhe I. A. u arrestuan më 6 janar nën dyshime të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe marrje e ryshfetit.

B. H., kryeinspektor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare; A. Ç., ish-sekretar i përgjithshëm i kësaj ministrie, dyshohet për po të njëjtën veprë penale si dhe për marrje të

ryshfetit. I pandehuri I. A. dyshohet se ka dhënë para ndaj personit zyrtar “që të veprojë në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare”, tha Prokuroria Themelore e Ferizajt. “Gjykata në këtë rast gjen se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të lartpërmendura dhe ky dyshim i bazuar mbështetet në faktet dhe provat të cilat janë të bashkangjitura deri në këtë fazë”, është thënë në njoftimin e Gjykatës së Ferizajt.

Më 6 janar autoritetet njoftuan se lidhur me rastin “Brezovica” kanë ngrirë rreth 6 milionë euro të të pandehurve, që dyshohet se i



kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

Policia kreu bastisje në nëntë lokacione në Prishtinë, Ferizaj dhe Shtërpcë, përfshirë edhe

disa zyra të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ky rast ka të bëjë me lëshimin e lejeve të ndërtimit në mënyrë të

kundërligjshme në Brezovicë të komunës së Shtërpcës.

Në dhjetor të vitit 2021, lidhur me rastin “Brezovica”, u arrestuan dhjetë persona, përfshirë edhe ish-kreun e komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikoliq. Ai dyshohet se ka fituar në mënyrë të kundërligjshme një milion euro. Nikoliq dhe të arrestuarit e tjerë dyshohet se kanë marrë vila, vettura dhe dhurata të tjera në këmbim të lëshimit të lejeve për ndërtimin e vilave dhe objekteve të tjera në Parkun Kombëtar “Sharri”, ku gjendet edhe Brezovica. Brezovica është e njohur për qendrën e skijimit.

Në Skenderaj protestohet kundër vrasjes së gruas nga Llausha



SKENDERAJ, 7 JANAR - Në Skenderaj është protestuar kundër dhunës dhe vrasjes së grave, duke dënuar vrasjen e Lirije Qerimajt nga bashkëshorti në Llaushë të Skenderajt.

Protesta është organizuar nga OJQ

“Gratë Intelektuale të Drenicës”, ku është marshuar nga sheshi “Adem Jashari” deri te gjykata, më pas para Stacionit Policor në Skenderaj.

Vrasja e rëndë ka ndodhur të mërkurën në fshatin Llaushë të Skenderajt.

Gratë kanë mbajtur afishe në duar me mbishkrimet “Vrasja nuk është virtyt, por forma më e ulët e ligësisë”, “Nëse nuk di të duash, mos merr jetë” etj.

Sipas Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, ekziston dyshimi i

bazuar se i dyshuari S. Q., me datë 5 janar 2022 në fshatin Llaushë të Skenderajt me dashje ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij me iniciale L. Q. ashtu që, pas një mosmarrëveshjeje të vazhdueshme me viktimën, ka

nxjerrë armën nga xhepi i jaknës dhe ka shtënë gjashtë herë në drejtim të viktimës, të cilën e ka goditur në trup dhe, si pasojë e plagëve të marra, viktimë ka ndërruar jetë gjatë rrugës për në Spitalin Rajonal të Mitrovicës.

Bislimi: Qeveria e gatshme ta vazhdojë procesin e dialogut

PRISHTINË, 7 JANAR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, shef i delegacionit të Kosovës në dialogun me Serbinë, ka thënë se Qeveria e Kosovës është e gatshme ta vazhdojë procesin e dialogut. Ai ka deklaruar se këtë tashmë ua ka bërë me dije vendeve aleate të saj në takimet që ka pasur muajt e fundit. “Qeveria e Kosovës është e gatshme ta vazhdojë procesin e dialogut ashtu siç ka bërë deri më tani, për



arritje të një marrëveshjeje finale gjithëpërfshirëse e cila do ta sillte njohjen e Kosovës

nga Serbia. Qasja jonë është plotësisht e hapur dhe konstruktive, por është e

bazuar në parime që sot janë bazament i politikës së jashtme të shteteve të NATO-s”, ka thënë Bislimi në një përgjigje me shkrim për “Radion Evropa e Lirë”.

Në dhjetor të vitit të kaluar presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se Serbia dëshiron vazhdimin e dialogut, por i ka akuzuar autoritetet e Kosovës se nuk duan ta vazhdojnë procesin. Bashkimi Evropian ka rolin e lehtësuesit të dialogut Kosovë - Serbi dhe Qeveria e

Kosovës vlerëson se BE-ja e ka ruajtur neutralitetin minimal në këtë proces. “Megjithatë, qeveria pret nga Bashkimi Evropian që të ruajë një kornizë të dialogut që është e bazuar në vlerat e traktateve të saj themeluese dhe një qasjeje që e promovon sigurinë regjionale të Ballkanit Perëndimor, në pajtueshmëri me pritjet e NATO-s dhe në mbrojtje të regjionit tonë nga ndikimi rus dhe kinez”, ka thënë Bislimi.



NË MOSHËN 93-VJEÇARE KA NDËRRUAR JETË AJSHE VESELI, NËNA E KADRI VESELIT

I jepet lamtumira e fundit nënës së Kadri Veselit

Ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe të PDK-së, Kadri Veseli, i cili gjendet në paraburgim në Hagë, të premtën i ka vdekur nëna. Ajshe Veseli ka vdekur në moshën 93-vjeçare. Ajo është varrosur në Broboniq të Mitrovicës. Për këtë humbje të madhe familjen Veseli e kanë ngushëlluar krerët e institucioneve, bashkëpartiakët dhe ish-bashkëlufëtaret e Kadri Veselit. Në telegramet e ngushëllimit të tyre nëna Ajshe është vlerësuar si grua e fortë dhe bujare, e cila rriti dhe edukoi bijtë e saj në frymën e atdhedashurisë. Gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim, Veselit i ka vdekur edhe babai, Fazli Veseli

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 JANAR - Në moshën 93-vjeçare ka vdekur Ajshe Veseli, nëna e ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, Ajshe Veseli. Për këtë lajm të hidhur, Veselin, i cili gjendet në paraburgim në Hagë, e kanë ngushëlluar shumë bashkëpunëtorë, ish-bashkëlufëtare, udhëheqës të institucioneve dhe i gjithë spektri politik.

Pasditën e së premtes, në Broboniq të Mitrovicës, i është dhënë lamtumira e fundit nënës së Kadri Veselit. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë numër i madh i qytetarëve dhe bashkëpartiakë

të Kadri Veselit.

Në telegramet e tyre të ngushëllimit ata kanë vlerësuar se nëna Ajshe ishte grua e fortë e bujare, e cila rriti dhe i edukoi bijtë e saj në frymën e

atdhedashurisë. “Me dhimbje e pranova lajmin për ndarjen nga jeta të nënës suaj, Ajshe Veseli. Ajo jetoi afër një shekull dhe ishte një grua që u sfidua, sakrifikoi dhe u dëshmuar, duke

luajtur rol të rëndësishëm në kultivimin e atdhedashurisë në familje. Kujtimi për nënën mbetet i paharruar, ndaj e nderuar familje Veseli jetoni me kujtimet më të mira për nënën Ajshe! Në këto çaste të vështira, bashkëndiej me ju!”, është thënë në telegramin e ngushëllimit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani.

Me rastin e vdekjes së Ajshe Veselit, edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka ngushëlluar familjen Veseli.

“Me keqardhje mora lajmin e ndarjes nga jeta të Ajshe Veselit. Në këtë ditë pikëllimi, në emrin tim dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i shpreh ngushëllime ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Kadri Veseli dhe mbarë familjes Veseli”, ka thënë kryeministri Kurti.

Me keqardhje vdekjen e nënës Ajshe e ka prituri i gjithë spektri politik.



Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka deklaruar se nëna Ajshe i ka mbyllur sytë pa e pasur pranë djalin e saj, Kadriun. “Në këtë fillimvit me dhembje të madhe morëm lajmin për vdekjen e nënës së ish-kryetarit Kadri Veseli, nënës Ajshe. Nëna Ajshe ishte grua e fortë e bujare, nënë e një heroi të gjallë, që i rriti e i edukoi bijtë e saj në frymën e atdhedashurisë. Një jetë e tërë

me sakrifica, pa kursyer asgjë nga vetja, ku krenaria mposhti mallin për të birin, që në çdo etapë i shërbeu Kosovës. E tillë ishte jeta e nënës Ajshe, e cila i mbylli sytë pa e pasur pranë djalin, Kadriun. Unë dhe gjithë Partia Demokratike e Kosovës sot i bashkohemi dhimbjes së familjes Veseli dhe i shprehim ngushëllimet më të sinqerta”, ka shkruar në profilin e vet në “Facebook”, kryetari i PDK-së,

Memli Krasniqi.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se nëna Ajshe e kishte jetën plot sfida. “I pikëlluar nga lajmi për vdekjen e nënës Ajshe. Një jetë e tërë në ankth e sfida, aspak e lehtë për të. Ngushëlloj me këtë rast bashkëluftëtarin tim, ish-kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli dhe mbarë familjen e tij. Nëna Ajshe u prehtë në paqe!”, ka shkruar Haradinaj në

llogarinë e vet në “Facebook”.

Ngushëllime familjes Veseli i ka shprehur edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. “Me pikëllim mora lajmin për ndarjen nga jeta të nënës Ajshe Veseli. I shpreh ngushëllimet më të sinqerta bashkëluftëtarit tim, ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli dhe gjithë familjes Veseli. Nëna Ajshe rriti dhe edukoi fëmijët e saj me frymën e

atdhedashurisë. U prehtë në paqe!”, është thënë në telegramin e ngushëllimit të Limajt.

Gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim në Hagë, më 7 korrik të vitit të kaluar, Veselit i ka vdekur edhe babai, Fazli Veseli. Kadri Veseli është duke u mbajtur në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë, nën dyshimin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



550 mijë shqiptarë janë larguar nga viti 1969

PRISHTINË, 7 JANAR - Referuar statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), mësohet se brenda 53 vjetësh Kosovën e kanë lëshuar më shumë se gjysmë milionë qytetarë. Njohësi i proceseve politike, Besnik Vasolli, ka thënë se, sipas statistikave zyrtare të ASK-së, Kosovën e kanë lëshuar më shumë se 550 mijë qytetarë që nga viti 1969. Po ashtu, Vasolli ka thënë se llogaritet se nga këta 550 mijë qytetarë të migruar,

janë edhe rreth 890 mijë fëmijë të tyre që jetojnë në vende të ndryshme të botës. "Prej vitit 1969 llogaritet që Kosovën e kanë lëshuar mbi 550 mijë banorë, prej tyre fëmijët e tyre llogariten që janë gati 890 mijë kosovarë që jetojnë në Evropë. Gjermania, siç duket, do t'i lehtësojë edhe më tutje masat, pasi ka nevojë për fuqi punëtore, në anën tjetër kosovarët kanë nevojë për punë. Ne kemi një rini të mirë e cila nuk ka pasur fatin t'i ketë

mundësitë që duhej t'i kishte dhe kjo i tërheq ata që të mendojnë të largohen nga vendi", ka thënë Vasolli. Sipas tij, një rol të madh në migrimin e kosovarëve në vendet e zhvilluara të Evropës e luan edhe diaspora. "Njerëzit nuk migrojnë vetëm për shkak të pagës, por edhe për shkak të së ardhmes së fëmijëve të tyre, aspektet e shëndetësisë, të zhvillimit profesional, por edhe për aspekte të sigurisë. Në rastin

tonë mendoj që edhe diaspora e luan rolin e rëndësishëm, sepse ne kemi anëtarët e familjes sonë atje dhe i shohim si jetojnë atje. Kur të vijë këtu krijohet perceptimi se ata jetojnë një jetë të mirë. I shohim kur vijë këtu se janë gazmorë, të hareshëm e duke shëtitur dhe mendojmë se realiteti është ashtu. Mirëpo kur shkojnë atje, një numër i tyre zhgënjehen pasi edhe atje e shohin se duhet të punojnë shumë për të arritur

mirëqenien", ka thënë Vasolli, i cili ka shtuar se, përveç kësaj, luan rol edhe fakti që shumë qytetarë të Kosovës që jetojnë në Evropë kanë hapur bizneset e tyre atje dhe kështu ua bëjnë më të lehtë familjarëve të tyre largimin nga Kosova. Vasolli ka thënë se shteti i Kosovës duhet të krijojë mundësi për mirëqenie të të rinjve në mënyrë që ata të mos mendojnë largimin pasi, sipas tij, nga ikja e trurit humb shumë vendi.



SBASHK-u: Nëse nuk respektohen afatet për Ligjin e Pagave, mund të ketë grevë



PRISHTINË, 7 JANAR - Sindikata e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (SBASHK) ka bërë me dije se nëse qeveria nuk u përmbahet afateve për Ligjin e Pagave deri në mars, atëherë do të ketë grevë. Përmes një komunikate për medie, SBASHK-u ka vlerësuar se qeveria do të jetë përgjegjëse për mosmbajtjen e premtimit të dhënë.

Ky paralajmërim, sipas kësaj sindikate, nuk është as shantazh dhe as kërcënim. "Kemi kërkuar me ngulm që

ministrja Nagavci të kërkojë nga qeveria Kurti që të kryhet obligimi moral dhe njerëzor ndaj 400 punëtorëve të arsimit me sëmundje të rënda e të veprojë, së paku, siç bëri qeveria Hoti që siguroi mjete buxhetore dhe liroi nga procesi mësimor për një vit këta njerëz, që vuajnë nga sëmundje të rënda, por në vitin 2021 kjo nuk u realizua. Ne insistuam e apeluam edhe për vaksinimin e punëtorëve të arsimit dhe apeli ynë u dëgjua nga të gjithë dhe tani kemi më

shumë se 95 për qind të punëtorëve arsimorë të vaksinuar. Ne e kemi thënë publikisht në emër të punëtorëve të arsimit se jemi të gatshëm e të përkushtuar që, pavarësisht prej vështirësive të mëdha të krijuara nga pandemia, ta mbajmë procesin mësimor në institucione arsimore. Ne dëshmuam dhe do të dëshmojmë se jemi në shërbim të arsimit, por edhe në shërbim të kërkesave të anëtarëve", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Kosova regjistron edhe 144 të infektuar me Covid

PRISHTINË, 7 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë janë regjistruar 144 raste të reja me koronavirus, ndërsa nuk është regjistruar asnjë i vdekur. Rastet e reja dolën pas testimit të 3 908 mostrave.

Në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 19 pacientë, ndërkaq raste aktive janë 997. Sa i përket vaksinimit, autoritetet shëndetësore kanë administruar edhe 4 010 doza të vaksinës kundër koronavirusit. Që prej fillimit të fushatës së imunizimit, me

dy doza të vaksinës janë imunizuar 788 240 persona. Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç, ndërkaq personat mbi 18 vjeç që kanë marrë dozën e dytë para tre muajsh, mund ta marrin edhe dozën përfunduese dhe atë të tretë.



Prodhuesit e kriptovalutave: Qeveria po na detyron t'i shesim



PRISHTINË, 7 JANAR - Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndalimin e prodhimit të kriptovalutave ka bërë që disa qytetarë të fillojnë t'i shesin pajisjet e tyre nga të cilat kanë fituar mijëra euro në vitet e fundit.

Njoftimet për shitje po bëhen kryesisht në grupe të ndryshme në rrjete sociale, ku zakonisht diskutohet vetëm për çështjen e kriptovalutave.

Çmimet janë nga të ndryshme, duke filluar nga 1 500 e deri në 8 mijë euro, varësisht prej pajisjes. "Radio Evropa e Lirë" ka komunikuar me disa prej tyre, të cilët në kushte anonimiteti kanë thënë se janë detyruar t'i ndalin pajisjet të cilat i kanë blerë më shtrenjtë dhe tash po i shesin më lirë. Një prej tyre, në një përgjigje me shkrim, ka thënë se është detyruar t'i shesë tri pajisjet e tij pasi nuk dëshiron të veprojë në mënyrë kundërligjore. "I kam pasur tri pajisje dhe të tria i kam shitur, sepse qeveria nuk ka dhënë afat se për sa kohë do të ndalohet prodhimi i

kriptovalutave. Po të kishte një afat, do t'i ndalonim përkohësisht. Të tri pajisjet i kam shitur 1 500 euro", ka thënë ai.

Shitblerja e pajisjeve për prodhim të kriptovalutave po bëhet edhe në një grup me qindra qytetarë në aplikacionin "Telegram". "Kam filluar që më shumë se gjashtë muaj të prodhoj kriptovaluta. Për momentin kam një pajisje (Rig 5700xt 6-GPU). E kam blerë shtatë mijë euro. Pesë mijë euro i kam marrë kredi për ta blerë. Çdo muaj prej kësaj pajisje i kam fituar 500 deri 600 euro", ka thënë një prej tyre në kushte anonimiteti.

Vendimi i qeverisë për ndalimin e prodhimit të kriptovalutave, sipas tij, është pak i ngutshëm dhe shpreson që i njëjti të anulohet. Ai ka thënë se ende nuk ka vendosur nëse do ta shesë pajisjen pasi që, sipas tij, nuk shpenzon shumë rrymë.

Përveç shitjes së pajisjeve, qytetarët kanë filluar t'i tërheqin fitimet e tyre të fituara nga

prodhimi i kriptovalutave. Njëra nga kompanitë për këmbimin e kriptovalutave në Prishtinë ka thënë se ata qytetarë që kanë kriptovaluta tashmë kanë filluar t'i tërheqin fitimet, ndonëse aktualisht vlera e tyre ka rënë.

Ardian Alaj, bashkëpronar i njëres prej kompanive për këmbim të kriptovalutave, ka thënë se më 4 dhe 5 janar ka qenë një fluks më i madh i njerëzve të cilët kanë këmbyer valutat e tyre. Ai ka thënë se vendimi i qeverisë nuk ka pasur shumë sqarime dhe njerëzit ndihen të rrezikuar se çfarë do të ndodhë me valutat e tyre. "Kemi klientë të rregullt që çdo muaj vijnë i konvertojnë fitimet e tyre për nevojat e tyre personale, por këto dy ditë fluksi i njerëzve ka qenë më i madh dhe sasia e këmbimit të valutave ka qenë shumë e madhe krahasuar me muajt paraprakë", ka thënë Alaj. Sipas tij, pas vendimit të qeverisë për ndalimin e prodhimit të kriptovalutave, ka filluar të bjerë

çmimi i pajisjeve në faqe të ndryshme online ku qytetarët i postojnë fotografitë e pajisjeve të tyre. "Ajo çka po vërehet është se çmimi i pajisjeve ka pësuar rënie shumë të madhe. Zakonisht blerja e një pajisje ka kushtuar deri 5 mijë euro. tash mund të gjendet në treg me 2 000-2 500 euro", ka thënë Alaj. Sipas Doganës së Kosovës, vetëm gjatë vitit 2021 në Kosovë janë importuar pajisje për prodhim të kriptovalutave në vlerë rreth 600 mijë euro.

Qeveria zotohet se do t'i ndalojë kriptovalutat edhe në veri

Qeveria e Kosovës ka bërë me dije të enjten se do të identifikohen lokacionet e prodhimit të kriptovalutave në të gjithë Republikën e Kosovës. Në dy operacione të ndara, Policia e Kosovës tha më 6 janar se ka sekuestruar 70 aparate për prodhimin e kriptovalutave.

Nëpërmjet një përgjigjeje me shkrim dërguar "Radio Evropa e Lirë", zyra për media e qeverisë ka njoftuar se pas identifikimit do të ndërpritet prodhimi i kriptovalutave, duke përfshirë edhe veriun e Mitrovicës. Mirëpo zëdhënësi i Kompanisë Kosovare për Distribucion të Energjisë Elektrike (KEDS), Viktor Buzhala, ka thënë të mërkurën për "Radio Evropa e Lirë" se kjo kompani e ka të pamundur t'i identifikojë lokacionet ku prodhohen kriptovalutat, aq më pak në veri të Kosovës. "Identifikimi i lokacioneve ku prodhohen kriptovaluta nuk është kompetencë e KEDS-it. Dihet që nuk e furnizojmë veriun dhe nuk kemi qasje atje, e kemi të pamundur", ka thënë Buzhala, duke shtuar se e kanë të vështirë të dinë edhe sa shpenzojnë rrymë këto pajisje.

Në përgjigjen e Qeverisë së Kosovës është thënë se "në vitin 2021 është rritur konsiderueshëm konsumi i energjisë elektrike dhe një ndër faktorët e rritjes së konsumit besohet të jetë prodhimi i kriptovalutave në vend, me theks të veçantë në veri të vendit". "Sa për ilustrim, prodhimi i një kriptovalute, duke marrë parasysh shifrat konservative, konsumon energji sa 19 shtëpi kosovare mesatare në vit", është thënë në përgjigje.

Që prej vitit 1999 furnizimi me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës është problem. Që nga ajo kohë qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit nuk paguajnë për energjinë e shpenzuar.

Rreth 12 milionë euro në vit llogaritet fatura e përbashkët e energjisë së shpenzuar në katër komuna në veri të Kosovës. Së fundmi, Kosova po përballet me krizë energjike pas rritjes së importit të energjisë. Autoritetet kanë miratuar masat emergjente për energji. Qeveria e Kosovës ka njoftuar të martën, më 4 janar, se institucionet kompetente do të angazhohen që të ndalojnë prodhimin e kriptovalutave, pasi dyshohet se pajisjet me të cilat prodhohen ato shkaktojnë konsum të lartë të energjisë elektrike.

Buzhala: Gjendja me energji është stabile

PRISHTINË, 7 JANAR - Gjendje e furnizimit me energji elektrike në vend aktualisht është e qëndrueshme ka deklaruar zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, i cili ka thënë se ka më tepër që një javë që qytetarët janë duke u furnizuar pandërprerë me rrymë. "Megjithatë, situata është fragjile. Jemi në gjendje emergjente të shpallur nga


Qeveria e Kosovës. Ka shumë faktorë që tash për tash janë në favorin tonë, përfshirë kohën, që ka rënë konsumi dhe çmimi i energjisë në berëzat ndërkombëtare. Koha dhe çmimi i berëzës po na mundësojnë të kemi furnizim stabil me energji", ka thënë Buzhala në emisionin "Portofol" në "Klan Kosova FM". Buzhala ka thënë se aktualisht gjysma e rrymës që konsumohet

është nga importi. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve të përdorin drurin dhe peletin për ngrohje. "Çmimi është 200 euro për megavat. Qytetarëve s'u themi ta përdorin qeben, por që të përdorin më shumë dru dhe pelet për ngrohje. Nuk mund të flasim për banesa kolektive, por në vendet e tjera ku ka mundësi, sepse do të na lehtësonte barrën", ka thënë Buzhala.



UMBERTO ECO DHE MËSIMET E JETËS SË NJË MJESHTRI TË JASHTËZAKONSHËM

Të flasësh për të dhe tërësinë e tij është e vështirë, ndoshta pothuajse e pamundur. Por ne mund ta kujtojmë atë përmes fjalëve, mendimeve dhe shkrimeve të tij. Nëpërmjet mësimave të çmuara



Filozof, shkrimtar, gazetar, semiolog dhe eseist, e pastaj sërish opinionist, humorist, profesor universiteti dhe bibliofil. Umberto Eco ka qenë shumë gjëra në jetën e tij dhe do të ishte e pamundur t'i rendisje të gjitha, sepse ai profesionalisht ka arritur të përmbushë shumë role, duke mos lejuar asnjëherë që të përkufizohet individualisht prej tyre. Është e vështirë të rrefesh njeriun në tërësi, por ne mund ta kujtojmë atë për gjithçka që na mësoi dhe për gjithçka që na

la. Ai që ishte dhe do të jetë gjithmonë mësues i jetës.

Umberto Eco, biografia e një mjeshtri

Pasionet e tij më të mëdha, ato që e udhëhoqën dhe e lidhën me njohjen e mbarë njerëzimit, janë ndarë me të gjithë ne përmes kryeveprave dhe një aktiviteti të zjarrtë kulturor që nuk ka të ndalur, ndër të cilat bestselleri "Emri i trëndafil", botuar në vitin 1980.

I lindur në Alessandria më 5 janar 1932, Umberto Eco zhvilloi një pasion të madh për filozofinë dhe kulturën mesjetare, të cilën nuk do ta braktiste më kurrë, gjatë viteve të universitetit në Fakultetin e Letërsisë dhe Filozofisë në Torino. Kësaj do t'i shtohet edhe një vëmendje e veçantë ndaj kulturës masive. Ai vetë do të deklaronte, me rastin e një interviste në wikinews.org, se është një "përdorues kompulsiv", i përkushtuar ndaj botës open source.

Pikërisht gjatë këtyre viteve, duke studiuar Tomas Aquinin, mbi të cilin do të shkruante tezën e tij, ai do të braktiste përgjithmonë besimin: "Edhe pse jam ende i dashuruar me atë botë, kam pushuar së besuari në Zot gjatë të 20-ave, pas studimeve universitare mbi Thomas Aquinas. Mund të them se ai më shëroi mrekullisht nga besimi im".

Vitet 1960 shënuan fillimin e karrierës së tij universitare. Filozofi jepte mësim në Torino, Milano, Firenze dhe Bolonja dhe ishte një nga themeluesit e DAMS. Njëkohësisht punoi si eseist dhe gazetar duke bashkëpunuar me gazetatat më të rëndësishme italiane. Megjithatë, në vitet 1980, ai iu afrua letërsisë artistike dhe fitoi çmimin Strega me botimin e tij të parë, "Emri i trëndafil", një best seller ndërkombëtar i përkthyer në 47 gjuhë.

Umberto Eco, mendimet e tij

Një nxënës i filozofit piemontez Luigi Pareyson, Umberto Eco zhvillon një mendim mbi realitetin bazuar në marrëdhëniet midis subjektit dhe objektit: e vërteta nuk mund të jetë kurrë e njëjtë, sepse ajo ndërtohet sipas një procesi interpretues subjektiv. Mendimi i Ecos sot jehon në të gjitha mësimet e tij, në librat e tij dhe në atë monografi "Filozofia e Umberto Eco-s", e cila është një homazh i vërtetë monumental për vetë ekzistencën e tij.

"Unë kam lindur në Alessandria, në veriperëndim të gadishullit italian. Nga karakteri i bashkëqytetarëve të mi kam mësuar vërtetë e skepticizmit, që nënkupton një sens humorit të vazhdueshëm, për të vënë në pikëpyetje edhe gjërat në të cilat njeriu beson sinqerisht. Ndoshta kjo shpjegon shumë raste në të cilat unë kam tallur, apo edhe parodizuar, tekste për të cilat kisha shkruar me bindje të madhe. Të mos e marrësh kurrë veten shumë seriozisht, më është dukur gjithmonë qëndrimi i duhur filozofik", thoshte ai.

Veprat e tij fshehin, debatet filozofike në të cilat ai vetë mori pjesë, si ekzistenca e Zotit, natyra, universi dhe boshllëku. Ai i përdorte romanet për të treguar histori që kanë ndodhur me të vërtetë ose për t'u përpjekur të shpjegonte legjendat dhe misteret që rrotullohen rreth figurave dhe situatave veçanërisht emblematike. Flet për Kalorësit Templarë, për shembull, dhe Graalin e Shenjtë tek "Lavjerrësi i Foucault". "Varrezat e Pragës", nga ana tjetër, është një roman monumental dhe cinik i përqendruar në teorinë e konspiracionit, në lidhje me historinë e popullit hebre. Umberto Eco u nda nga jeta më

19 shkurt 2016, por prania e tij është mbizotëruese në gjithçka që na la. Në gjithçka që na mësoi. Megjithatë, shumë gjëra mungojnë prej tij. Ashtu si shpirti i tij kritik, ironia, qartësia, kuptimi i së tashmes. Dhe mbi të gjitha aftësia për të qenë gjithmonë një hap përpara.

"Është e bukur diçka që, po të ishte e jona do të na bënte të lumtur, por që mbetet e bukur edhe nëse i përket dikujt tjetër", thoshte Eco.

Umberto Eco, mësimet e jetës

Të tregosh të gjitha mësimet e Umberto Ecos është e pamundur, sepse e gjithë jeta e tij bazohet në eksplorimin e njohurive dhe transmetimin e tyre. Megjithatë duam të përmbledhim disa prej tyre, ato që përmes fjalëve, shkronjave dhe rubrikave janë shndërruar në një mësim jete.

Si ajo që filozofi i kushtoi nipit të tij, përmes një reflektimi mbi teknologjinë dhe një këshillë më aktuale se kurrë, ajo e të qenit vigjilent "nga një sëmundje që ka prekur brezin tuaj dhe madje edhe atë të fëmijëve më të mëdhenj se ti: humbja e kujtesës". Kështu Umberto Eco, fton të gjithë të rinjtë e sotëm të studiojnë përmendësh, sepse nëse është e vërtetë që interneti nuk mund të zëvendësojë dijet, kompjuteri nuk mund të marrë rolin e trurit.

Dhe pastaj përsëri ai mësim mbi historinë, i konsideruar si mësim i jetës, që u zhvillua përmes fjalëve të filozofit, të shqiptuara me rastin e fjalimit në OKB kundër humbjes së kujtesës: "Problemi është se asnjë qytetërim (në kuptimin antropologjik të fjalës, i kuptuar si një sistem idesh shkencore dhe artistike, mitesh, fesh, vlerash dhe zakonesh të përditshme), nuk mund të ekzistojë dhe të mbijetojë pa një kujtesë kolektive".

Dhe në fund, ai mësim jete që duket thuhet një deklaratë dashurie ndaj njohjes së njerëzimit, fshehur në faqet e kryeveprës së tij, "Pse librat zgjasin jetën". "Libri është një sigurim jete, një parapritje e vogël e pavdekësisë. Në retrospektivë (mjerisht), dhe jo në perspektivë. Por nuk mund të kesh gjithçka", shkruan filozofi duke vënë theksin tek rëndësia e leximit jo vetëm për të pasuruar sfondin dhe gjuhën kulturore, por për të marrë një ndërgjegjësim të ri mbi veten dhe mbi realitetin. Dhe të jetojmë gjithë jetën që duam.

"Kush nuk lexon, në moshën 70-vjeçare do të ketë jetuar vetëm një jetë: të vetën. Lexuesi do të ketë jetuar 5000 vjet: që kur Kaini vrau Abelin, kur Renzo u martua me Lucian, kur Leopardi admironte pafundësinë... sepse leximi është një pavdekësi."

Bota.al

Albert Kamy: Nga Parisi në Berlin, në kërkim të unitetit të Europës

“Në 1955, shkrimtari i madh francez ka mbajtur këtë fjalim në Athinë, në një diskutim për Europën, mes plagëve të vjetra dhe shpresave të reja: “Liria pa kufi është e kundërta e lirisë. Vetëm tiranët mund të ushtrojnë lirinë pa limite; dhe për shembull, Hitleri ishte relativisht një njeri i lirë, i vetmi në të gjithë perandorinë e tij. Por nëse duam të ushtrojmë një liri të vërtetë, nuk mund të ushtrohet vetëm në interes të individit që e ushtron. Liria ka patur gjithmonë si kufi, lirinë e të tjerëve” -Camus.

Nëse besojmë se qytetërimi perëndimor konsiston mbi të gjitha në humanizimin e natyrës, domethënë në teknikat dhe në shkencën, Europa jo vetëm ka triumfuar, por forcat që sot e kërcënojnë, kanë huazuar nga Europa perëndimore teknikat dhe ambiciet e saj dhe, në cdo rast, metodën e saj shkencore apo atë të arsytimit. I parë kështu, qytetërimi evropian nuk është i rrezikuar, përveçse nga ndonjë vetëvrasje e përgjithshme. Nëse, e anasjelltas, besojmë se qytetërimi ynë është zhvilluar mbi konceptin e qnies humane, ky këndvështrim, që mund të jetë i vlefshëm, con në një përgjigje krejt tjetër. Ndoshta është e vështirë të gesh një epokë në të cilën numri i njerëzve të poshtëruar të ketë qenë kaq i madh. Megjithatë, nuk do të thoja që kjo epokë përcmon në vecanti qenien njerëzore. Në fakt, njëkohësisht me këto forca, që do t'i quaja të së keqes për të thjeshtësuar gjërat, nuk ka dyshim që përgjatë shekujve është përhapur në mënyrë progresive një reaksion i ndërgjegjes kolektive dhe në mënyrë të vecantë i ndërgjegjes së të drejtave individuale.

Dy luftërat botërore vetëm sa e kanë lodhur pak dhe besoj se është e arsyeshme të përgjigjemi që qytetërimi ynë rrezikohet, në po të njëjtën masë sa, qenia njerëzore sot, kudo e nga pak, poshtërohet. Këtij dallimi të dobishëm mund t'i shtoj se ne ndoshta mund të ngrejmë pyetjen që, mos vallë pikërisht suksesi i qytetërimin perëndimor në aspektin e vet shkencor, është pjesërisht fajtor për dështimin moral të këtij qytetërimi? Për ta thënë ndryshe, mos vallë, në një farë kuptimi, besimi absolut, i verbër, në fuqinë e arsyes racionaliste – të themi në arsyen karteziene për të thjeshtësuar gjërat, sepse është kjo arsye në qendër të dijes bashkëkohore – është përgjegjës në një farë mase për kufizimin e ndjeshmërisë

njerëzore që ka mundur, gjatë një procesi të gjatë për ta shpjeguar, të shkaktojë pak e nga pak këtë degradim të universit personal.

Universi teknik në vetvete nuk është një gjë e keqe, dhe jam absolutisht kundër të gjithë atyre teorive që kërkojnë kthimin tek rrota, apo plugu i tërhequr nga buajt. Por arsyeja teknike, e vendosur në qendër të universit, konsideruar si agjenti mekanik më i rëndësishëm i një qytetërimi, përfundon duke provokuar një lloj perversioni, si tek inteligjenca, ashtu edhe tek zakonet, që rrezikon të çojë në dështim atë për të cilin kemi folur. Do të ishte interesante të përipiqeshim të kuptonim se si e bën këtë.

(...) Cilët janë, mbi të gjitha, elementët që përbëjnë qytetërimin evropian? Ju përgjigjem që nuk e di. Megjithatë, secili prej nesh ka një këndvështrim të privilegjuar, sentimental në një farë mënyre, që për më tepër mund të arsyetohet bazuar mbi vëzhgime, e që na bën të preferojmë një prej këtyre elementëve, kundrejt të tjerëve. Sipas meje, qytetërimi evropian është pikësisht një qytetërim pluralist. Dua të them që ai është vendi i diversitetit të mendimeve, të kundërshtimeve, të vlerave që bien ndesh dhe të dialektikës që nuk arrin në një sintezë. Në Europë, dialektika e gjallë është ajo që nuk con në një lloj ideologjie njëkohësisht totalitare dhe ortodokse. Më duket se kontributi më i rëndësishëm i qytetërimin tonë është ai pluralizëm, që ka qenë gjithmonë themeli i nocionit të lirisë europiane. Sot, është pikërisht ky që është në rrezik dhe këtë duhet të përipiqemi të ruajmë.

Shprehja e Volterit, që më duket se ka thënë se “nuk mendoj si ju, por do të luftoja deri në vdekje për t'ju lënë të shprehni mendimin tuaj” është natyrshëm një parim i mendimit evropian. Nuk ka dyshim, që sot në planin e lirisë intelektuale, por edhe



në plane të tjerë, ky parim vihet në diskutim, sulmohet dhe më duket se duhet mbrojtur. Në lidhje me pyetjen, për të ditur nëse në fund do të shpëtohet dhe nëse në fund e ardhmja do të jetë e jona, sic thuhet, pikërisht këtyre lloj pyetjeve u përgjigjem në të njëjtën mënyrë sic u përgjigjem të tjerave, që i ngre vetvetes në situata të ngjashme. Në disa rrethana, më duket se një njeri mund të përgjigjet: “Kjo gjë është e vërtetë, sipas meje, apo ndoshta e vërtetë. Pra, kjo gjë duhet të jetojë. Nuk është e sigurtë që unë mundem ta bëj të jetojë, nuk është e sigurtë që atë që mua më duket thelbësore, nuk e pret vdekja. Sifidoqoftë, e vetmja gjë që mund të bëjë është që të luftoj që të mbesë e gjallë”.

Mendoj se në këtë fazë Europa është e mbyllur në një kuadër të ngurtë, në brendësi të të cilit nuk mundet të marrë frymë. Që nga momenti kur Athina është gjashtë orë nga Parisi, që në tre orë nga Roma shkohet në Paris, dhe që kufijtë ekzistojnë vetëm për doganierët dhe pasagjerët që i nënshtrohen juridiksionit të tyre, jetojmë në një shtet feudal. Europa, që ka qenë fillesa e ideologjive që dominojnë sot botën, e që sot i sheh të kthehen kundër saj, teksa janë mishëruar në vende më të mëdhenj dhe më të fuqishëm industrialisht, kjo Europë që ka patur pushtetin dhe fuqinë që të teorizojë ideologji të tilla, në po të njëjtën mënyrë mund të gjejë forcën për të krijuar konceptet që mund të lejojnë kontrollin apo ekuilibrimin e këtyre ideologjive. Thjeshtë ka nevojë për frymëmarrje, për mënyra të menduarit që nuk janë provinciale, ndërkohë që për momentin

të gjithë mënyrat tona të të menduarit janë të tilla. Idetë pariziane janë provinciale; edhe ato athiniane, në kuptimin që kemi vështirësi të madhe për të patur kontakte dhe dije të mjaftueshme, duke qenë se idetë tona janë të izoluara në vendet respektive. E megjithatë mendoj që ky ideal, drejt të cilit të gjithë duam të shkojmë, që duhet ta mbrojmë dhe për të cilin duhet të bëjmë të pamundurën, nuk do të realizohet shumë shpejt. “Sovraniteti” për shumë kohë ka vënë shkopinj në të gjithë rrotat e historisë ndërkombëtare. Do të vazhdojë ta bëjë. Plagët e luftës janë ende shumë të hapura, shumë të dhimbshme për të shpresuar që kolektiviteti i kombeve do të bëjë atë përpjekje, të cilën vetëm individë superiorë janë në gjendje ta bëjnë, e që konsiston në dominimin e ndjenjave.

Pra, psikologjikisht ndodhemi përballë pengesave që e bëjnë të vështirë realizimin e këtij ideali. Thënë kjo, duhet luftuar për të kapërcyer pengesat dhe për të bërë Europën, më në fund Europën, ku Parisi, Athina, Roma, Berlini do të jenë qendrat nevralgjike të një perandorie të mesme, e që do të luajë rol në historinë e të nesërme. Rezerva e vogël që do të paraqes është si vijon. Është thënë se nuk mund të përballim nga pikëpamja intelektuale problemi i të ardhmes europiane, që nuk mund të reflektohet deri sa nuk kemi atë strukturë të cilës mund t'i referohemi. Ajo që dua të them është: ne duhet të përballemi me problemin, t'u japim përmbajtje vlerave europiane, edhe pse Europa

nuk do të bëhet nesër. Më goditi pak shembulli që dëgjova. Ju thatë: “Gjermania, kur nuk ishte e bashkuar, nuk ishte një fuqi”. Është e vërtetë. Madje, duhet të themi se pjesa më e madhe e ideologjive bashkëkohore janë formuar mbi ideologjinë gjermane të shekullit XIX, dhe që të gjithë filozofët gjermanë që kanë bërë të lindë ajo formë e re mendimi, i paraprijnë bashkimit gjerman, natyrisht nëse konsiderojmë që bashkimi gjerman u realizua në 1871. Pra, është e mundur të ndikosh mbi një qytetërim, edhe në gjendjen e braktisjes dhe varfërisë ku ndodhemi.

Roli i intelektualëve dhe shkrimtarëve është në një farë kuptimi ai i vazhdimit të punës në fushën e tyre, të përipiqen të shtyjë rrotën e historisë, nëse mund ta bëjnë e nëse kanë kohë. (...) Liria pa kufi është e kundërta e lirisë. Vetëm tiranët mund të ushtrojnë lirinë pa limite; dhe për shembull, Hitleri ishte relativisht një njeri i lirë, i vetmi në të gjithë perandorinë e tij. Por nëse duam të ushtrojmë një liri të vërtetë, nuk mund të ushtrohet vetëm në interes të individit që e ushtron. Liria ka patur gjithmonë si kufi, lirinë e të tjerëve. Dua të shtoj që ajo ekziston dhe ka një kuptim vetëm nëse limitohet nga liritë e të tjerëve. Një liri që sjell vetëm të drejta, nuk do të ishte liri, por vetëm tirani. Por, nëse sjell të drejta dhe detyrime, është një liri që ka përmbajtje dhe mund të jetojë. Pjesa tjetër, liria pa limite nuk jetojë dhe ka si cmim vdekjen e të tjerëve. Liria me limite është e vetmja gjë që bën të bashkëjetojnë atë që e ushtrojnë dhe ata në favor të të cilëve ushtrohet.

(fragmente A. Kamy, 1955)

Gjërat e reja që mësuam rreth evolucionit njerëzor gjatë vitit 2021



Nga Briana Pobiner & Ryan MCRAEV

2021-shi, ka qenë një vit përparimi në tejkalimin e efekteve të pandemisë së Covid-19, por edhe në kërkimet mbi evolucionin e njeriut. Ja cilat janë disa nga gjërat e reja që mësuam këtë vit rreth evolucionit të specieve sonë:

Fosilet e reja të Paranthropus robustus nga Afrika e Jugut, tregojnë mikroevolucionin brenda një specieje të vetme

Evolucioni i njeriut ndodhi vetëm gjatë 5 deri në 8 milionë viteve, një hapësirë kohore shumë më e vogël krahasuar me rreth 200 milionë vjet, që kur dinosaurët dhe gjitarët kishin një paraardhës të përbashkët. Prandaj, ndryshimet evolucionare në shkallë më të vogël brenda një specieje ose prejardhjeje të vetme me kalimin e kohës, të quajturamikroevolucione, janë shpesh të vështira për t'u zbuluar.

Fosilet e një specieje të hershme njerëzore, *Paranthropus robustus*, gjenden në shumë zona shpellore në Afrikën e Jugut. Kështu dosilet e *Probus* nga shpella Suartkrans, vetëm 32 km perëndim të Johannesburgut, datojnë rreth 1.8 milion vjet më parë, dhe tregojnë një kreshtë të dallueshme sagitale, pra një

kreshtë kockore në krye të kafkës, me nofullat e tyre që tregojnë një forcë kafshimi më efikase.

Ndërkohë fosilet e sapo zbuluara të *Probus* nga shpella e Drimolenit, rreth 35 km në veri të Johannesburgut, të përshkruar nga Xhesi Martin nga Universiteti La Trobe dhe kolegët në janar 2021, janë të paktën 200.000 vjet më të vjetër (2.04-1.95 milion vjet të vjetra) dhe kanë një kreshtë sagitale të pozicionuar ndryshe, dhe një forcë kafshimi më pak efikase. Dallimet midis fosileve e gjetura në të dyja vendet, nxjerrin në pah mikroevolucionin brenda kësaj specieje humahoide.

Fosilet e fëmijëve nga Kenia, Franca dhe Afrika e Jugut, na tregojnë se si ndryshuan me kalimin e kohës praktikatat e lashta dhe moderne të varrimit të njerëzve

Praktika e varrimit të qëllimshëm të njerëzve, ka nisur të paktën 100.000 vjet më parë.

Në nëntor, Maria Martinon-Torres nga CENIEH (Qendra Kombëtare Kërkimore mbi Evolucionin Njerëzor) në Spanjë, Nikol Boivin dhe Majkëll Petralja nga Instituti Maks Planck për Shkencën e Historisë Njerëzore në Gjermani, dhe kolegët tjerë njoftuan gjetjen e varrit më të vjetër të njohur njerëzore në Afrikë.

Bëhet fjalë për eshtrat e një

fëmijë 2 e gjysmë deri në 3 vjeç nga Panga Saidi në Kenia. Sipas të dhënave shkencore, fëmija i mbiquajtur "Mtoto" që do të thotë "fëmijë" në gjuhën kisualeze, u varros qëllimisht rreth 78.000 vjet më parë. Mënyra se si ishte pozicionuar koka e fëmijës tregon praktikën e vendosjes së ndjerit mbi një objekt që dekompozohet me kalimin e kohës, si për shembull një jastëk.

Në dhjetor, një ekip i udhëhequr nga Universiteti i Kolorados, Zhaimë Hoxhkins raportoi gjetjen e varrit më të vjetër të njohur të një foshnjeje njerëzore moderne në Evropë. Ajo ishte varrosur në Itali 10.000 vjet më parë, bashkë me kthetrën e një shqiponje, 4 varëse të bëra nga guackat, dhe më shumë se 60 rruaza guaska me forma të ndryshme.

Po ashtu ka pasur hipoteza se një specie e tretë, *Homo naledi*, që dihet se ka jetuar në Afrikën e Jugut midis rreth 335.000 dhe 236.000 vjet më parë, i varroste qëllimisht të vdekurit, dhe pse pa ndonjë kontekst ritual.

Sipas dëshmimeve gjenetike nga Çekia dhe Bullgaria, evropianët e parë kishin të afërm Neandertalë të kohëve të fundit

Njerëzit modernë, *Homo sapiens*, evoluan në Afrikë dhe u përhapën në çdo cep të botës. Por ne nuk e dimë më saktësi se si dhe kur ndodhën

migrimet më të hershme njerëzore. Bazuar në të dhënat gjenetike të ADN-së së Neandertalit, ekzistojnë ende sot tek 1.9 përqind e evropianëve.

Mbetjet e disa prej njerëzve më të hershëm në Evropë, u përshkruan këtë vit nga disa ekipe studiuësish. Por ato nuk ishin plotësisht njerëzore. Të tre *Homo sapiens* më të hershëm në Evropë, shfaqën dëshmi të ndërthurjes (përzierjes) të Neandertalit në të kaluarën e tyre të fundit genealogjike.

Në prill 2021, Kei Pryfer dhe një ekip nga Instituti Maks Planck për Shkencën e Historisë Njerëzore, analizoi një kafkë njeriut të gjetur në Zlati Kun, Çeki, që daton rreth 45.000 vjet më parë. Ajo përmban afërsisht 3.2 për qind të ADN-së së Neandertalit.

Por disa nga rajone që tregojnë përzierjen e Neandertalit, nuk ishin të njëjta me njerëzit modernë, dhe ky individ nuk është drejtpërdrejt stërgjysh i asnjë popullate të njerëzve modernë, gjë që do të thotë se ata i përkisnin një popullsie që nuk ka pasardhës të gjallë.

Një derr me lytha nga Indonezia, një kangur nga Australia, dhe një instrument prej guacke nga Franca, përfaqësojnë forma të ndryshme të artit antik

Aktualisht, arti më i vjetër përfaqësues ose figurativ në botë, është një pikturë në një shpellë që përshkruan figurën


e një derri të zbuluar në Leang Tedongnge, Indonezi, që daton të paktën 45.500 vjet më parë. Ndërkohë në shkurt 2021, një ekip i udhëhequr nga Damien Finç nga Universiteti i Melburnit në Australi, kreu analizën e disa pikturave të vjetra shkëmbore të bëra nga aborigjenët australianë, që datojnë rreth 17.000 deri në 13.000 vjet më parë.

Pikturat natyraliste përshkruajnë kafshë dhe disa bimë. Shembulli më i vjetër është piktura e një kanguri rreth 2 mtra e gjatë në tavanin e një strehe shkëmbore, e cila daton rreth 17.300 vjet më parë. Pikërisht në atë kohë, rreth 18.000 vjet më parë, një njeri i lashtë në Francë preu pjesën e sipërme të një guaskë duke e dhëmbëzuar atë, që ajo të përdorej si instrumenti më i vjetër frymor në botë.

Një ekip i udhëhequr nga Kerol Fric dhe Zhill Tostello nga Universiteti i Tuluzës në Francë raportoi në shkurt, se e riekzaminoi këtë guackë, të zbuluar në shpellën Marsulas në vitin 1931, duke përdorur skanimin CT.

Përveç modifikimeve të përshkuara më sipër, ata gjetën pika të kuqe në madhësinë dhe formën e gjurmëve të gishtërinjve në sipërfaqen e brendshme të guaskës, të bëra me pigmentin ngjyrë okër, që është përdorur shpesh për të bërë vepra arti në muret e shpellave.

Marrë me shkurtime nga "Smithsonian" – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Vushtrria, mision Superligën, rikthen Zabergjën dhe Eminin

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Vushtrria, është duke bërë gara në Ligën e Parë, por synimi i këtij klubi është rikthimi në Superligë. Për të arritur këtë mision drejtuesit e klubit kanë kthyer dy futbollistë të dëshmuar që e ndihmuan klubin të shpallet kampion, Dior Zabergja dhe Leart Emini



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

VUSHTRRI, 7 JANAR - Skuadra e Vushtrrisë ka filluar përgatitjet për sezonin pranveror. I pranishëm në përgatitjen e parë ishte kryetari i komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i shoqëruar nga nënkryetari Shpëtim Zhegrova dhe drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Medina Bunjaku. Kryetari u zotua se si komunë do të jenë pranë klubit për realizimin e objektivave. Në këtë takim u diskutua edhe për gjendjen infrastrukturore të stadiumit me objektet përcjellëse të saj që, sipas

kryetarit, shumë shpejt do të dalin me plan konkret për rregullimin e infrastrukturës brenda stadiumit. Klubi vushtrrias nuk ka humbur kohë dhe ka filluar edhe përforcimet, duke rikthyer dy futbollistë që mbi supë bartin përvojë të madhe, Dior Zabergja dhe Leart Emini. "Dior Zabergja dhe Leart Emini si bashkëlojtarë nga KF Arbëria kanë vendosur që në gjysmëstatorin pranveror të rikthehen në Vushtri, në sfidën për rikthimin në Superligën e Kosovës, në klubin ku kanë shkruar historinë në sezonin 2013/2014 duke fituar titullin kampion. Tashmë kur kemi hyrë në 100-vjetorin e

klubit është ndjenjë e jashtëzakonshme rikthimi i gladiatorëve që janë dëshmuar me angazhim dhe sukses! Ne u dëshirojmë suksese në paraqitje dhe që secili prej nesh e pret rikthimin në Superligën e Kosovës!", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë. Vushtrria sezonin vjeshtor e ka mbyllur në pozitën e parë të Grupit B. Kjo skuadër grumbulloi plot 26 pikë, një pikë më shumë se skuadra e dytë në tabelë, Ferizaj.

Gashi largohet nga Feronikeli

Futbollisti prishtinas Dren Gashi ka njoftuar për largimin nga FC Feronikeli. Lajmin e ka bërë me dije vetë lojtari përmes një postimi në faqen zyrtare në "Facebook". "Dua t'ju njoftoj se kemi ndërprerë bashkëpunimin me KF Feronikeli për shkak të gjendjes së klubit që tashmë është e ditur. Faleminderit të gjithëve për përkrahjen dhe ish-klubit i dëshiroj fat dhe suksese! Shpresoj të kthehet aty ku e ka vendin, në top ekipet e Kosovës... Faleminderit Tigrat e Zi - Drenas!", ka shkruar Gashi në "Facebook".

City 'tremb' Barcelonën dhe Realin për Haalandin

MANCHESTER, 7 JANAR - Manchester City dëshiron një qendërsulmues për korrikun dhe Erling Haaland është një prioritet kryesor për tregun e transferimeve të verës. Lamtumira e Ferran Torres, si dhe largimet e tjera, do të ishte një mënyrë për t'i mbledhur burimet e duhura financiare dhe më pas për të nënshkruar me sulmuesin norvegjez. Pavarësisht se norvegjezi dëshiron të luajë në Spanjë, teksa këtë e ka deklaruar



edhe publikisht, teksa mbetet për t'u parë mes Real Madridit apo Barcelonës, historia e transferimeve tregon se ka surpriza. City është një klub që ka financa

dhe mund t'i kënaqte si dëshirat e lojtarit, ambiciet e tij për trofe në Premierë Ligë dhe Champions, por njëkohësisht edhe ta joshte menaxherin Mino Raiola dhe babanë e Haalandit, me këtë të fundit që ka luajtur me Qytetarët në rininë e tij. E sigurt është që Haaland edhe për pesë muajt e ardhshëm do të luajë për Dortmundin, një skuadër që ishte trampolina më e mirë për të shkuar te një klub prestigjioz evropian.

SHKURT

FIFA publikon tre finalistët për më të mirin e vitit 2021

FIFA ka publikuar tre finalistët për çmimin e lojtarit më të mirë për vitin 2021. Robert Lewandowski, Lionel Messi dhe Mohamed Salah janë tre lojtarët që do të garojnë për këtë çmim. Në garë për "Topin e Artë" triumfoi Messi, duke mposhtur konkurrencën e Lewandowskit dhe Jorginhos, kurse tani në top treshe është Salah. Ceremonia e FIFA Awards do të mbahet më 17 janar, ditë e hënë.

Coutinho rikthehet në Angli, nënshkruan për Aston Villan

Philippe Coutinho është zyrtarisht lojtar i Aston Villës deri në fund të këtij sezoni futbollistik. Barcelona ka publikuar sot huazimin e sulmuesit brazilian. "Barcelona dhe Aston Villa kanë arritur marrëveshje për huazimin e futbollistit Philippe Coutinho deri në fund të sezonit", shkruhet në njoftimin e katalanasve në rrjetet sociale. Katalanasit e blenë Coutinho katër vjet më parë për 135 milionë euro nga Liverpooli dhe tani braziliani do të luajë sërish në Premierë Ligë. Barcelona shpreson që braziliani ta rigjejë formën e tij më të mirë.

Mourinho: Jam shumë i lumtur që e kam refuzuar Milanin

Vite më parë Jose Mourinhos iu kërkua që të ulet në stolin e Milanit. Këtë e konfirmoi vetë ishi i Interit, Realit e Chelseat. I irrituar pas humbjes së Romës së tij 3-1 në San Siro, në ndeshjen e parë për vitin 2022, Mourinho ka thënë se tani është edhe më i lumtur që vite më parë i ka thënë jo Milanit. "Ma ofruan stolin në Milano tre vjet më parë. E kam menduar për tri ditë, por jam shumë i lumtur që e mora atë vendim. Jam profesionist, por ka ende vend për emocione. Unë jam një i pasionuar pas Romës dhe do të jap gjithçka për këtë klub", është shprehur portugezi. "Duke parë atë që ndodhi sot, jam dy herë më i lumtur me vendimin tim", ishin fjalët e Mourinhos pas takimit.

Zidane në verë emërohet trajner i PSG-së

Leonardo dhe Nasser Al-Khelaifi e kanë mohuar disa herë që Zinedine Zidane është kontaktuar për stolin e PSG-së. Gjithsesi në Francë janë të sigurt që drejtuesit e klubit kryeqytetas e kanë vendosur se kush do të jetë trajneri sezonin e ardhshëm. RMC shkruan se Zidane do ta zërë vendin e Mauricio Pochettino në fund të sezonit. Ecuri e këtij sezoni nuk do të ketë asnjë ndikim, pasi vendimi është marrë.

Trippieri transferohet te Newcastle

Pas shumë diskutimeve mes klubeve, Kieran Trippier më në fund është transferuar te Newcastle Unitedi. Ka qenë klubi anglez që ka konfirmuar se ka transferuar reprezentuesin e Kombëtares së Anglisë nga Atletico Madridi. 31-vjeçari ka rënë dakord për një kontratë për dy vjet e gjysmë dhe tanimë është paraqitur lojtar i ri i Newcastle's. 'Laraskat' kanë paguar 15 milionë euro tek Atletico Madridi për t'i marrë shërbimet e mbrojtësit me përvojë. "Jam i lumtur që i bashkohem këtij klubi fantastik. Më pëlqeu vërtet koha ime në Madrid, por kur mësova për interesimin nga Newcastle Unitedi dhe pasi kisha punuar më parë me Eddie Howe, e dija se ky ishte vendi ku doja të transferoheja. Jam i vetëdijshëm se ka shumë punë përpara nesh, por i njoh mirë kërkesat e Ligës Premierë dhe e di se çfarë klubi i mrekullueshëm është ky me lojtarë shumë të talentuar. Mezi pres të filloj dhe jam i emocionuar për të dalë në St. James Park si lojtar i Newcastle's", ka thënë Trippier.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

